

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vlerësimi/ 'PISA 2025', Shqipëria ngjitet në renditje, Kumbaro: Kryesojmë Ballkanin Perëndimor në matematikë dhe shkencë
ADRESA	https://tpz.al/vleresimi-pisa-2025-shqiperia-ngjitet-ne-renditje-kumbaro-kryesojme-ballkanin-perendimor-ne-matematike-dhe-shkence-i332348
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:47:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 11:05:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2b347aaee132f860bcb39f6a962066447876e509716debef008675f7c77a00
TEKSTI	e328213ba02531353982111e0b66c2263b4d5a3f498810b10329dbd8b648e4d6
PAMJA	85b87511c297f9d89b6ca3179b338e49eefeac271970d25aebbe5524ff10c373

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	82e56235d785fd85106529ebe84f7c761eaac498d97a36272ad4a571d6b3c1d2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/82e56235d785fd85106529ebe84f7c761eaac498d97a36272ad4a571d6b3c1d2

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



FLASH!

18:08 PDK e konsideron Kuvendin të pakonstituuar dhe Qeverinë jokushtetuese: Do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese • 15:54 Zgjidhet qeveria e re e Kosovës, Albin Kurti p

AKTUALITET, 8 SEPTEMBER 2026, 13:05

Vlerësimi/ 'PISA 2025', Shqipëria ngjitet në renditje, Kumbaro: Kryesojmë Ballkanin Perëndimor në matematikë dhe shkencë

tpz.al TPZ



Arsimi shqiptar ka regjistruar një nga zhvillimet më të rëndësishme të viteve të fundit në matjet ndërkombëtare të performancës së nxënësve. Rezultatet e PISA 2025, të publikuara sot nga OECD në Bratislavë, tregojnë një përmirësim të ndjeshëm të nxënësve shqiptarë në të tre fushat kryesore të testimit: matematikë, shkencë dhe lexim.

Krahasuar me rezultatet e vitit 2022, Shqipëria është rritur me 65 pikë në matematikë, 59 pikë në shkencë dhe 50 pikë në lexim. Përtej përmirësimit ndaj vetvetes, rezultatet e reja e vendosin Shqipërinë në krye të vendeve të Ballkanit Perëndimor në matematikë, ndërsa në shkencë ndan rezultatet më të larta në rajon me Malin e Zi.

Të dhënat marrin një peshë të veçantë për shkak të dimensionit të testimit. Testimet e PISA zhvillohen me nxënës të moshës 15-vjeçare në rreth 90 vende të botës dhe synojnë të matinjo vetëm njohuritë e marra në shkollë, por edhe aftësinë e nxënësve për t'i përdorur ato në situata konkrete. Nga Shqipëria në testimin e vitit 2025 morën pjesë rreth 6 mijë nxënës.

Ministria e Arsimit, Mirela Kumbaro, e cila ndodhet në Bratislavë në ministerialin e vendeve të OECD-së ku po prezantohen rezultatet, e cilësoi zhvillimin si një lajm të rëndësishëm për sistemin arsimor shqiptar.

ide!

John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

Nga Thoma Gëllçi

"Liria punon", por duhen edhe 6 milionë dollarë!

Nga Mero Baze

Tej e Këtej



Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Messenger

Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

"Shqipëria në të tre testet që bëhen nga PISA, leximi, shkencat dhe matematika, ka rritje të konsiderueshme", deklaroi Kumbaro, duke konfirmuar rritjen prej 65 pikësh në matematikë, 59 në shkencë dhe 50 në lexim.

Sipas saj, rëndësia e rezultateve nuk qëndron vetëm te përmirësimi në raport me PISA 2022, por edhe te pozicioni i Shqipërisë krahasuar me vendet e tjera të rajonit.

"Në matematikë, Shqipëria ka nivelin më të lartë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, krahasuar me Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën. Në shkencë Shqipëria dhe Mali i Zi kryesojnë listën e rezultateve", tha ministrja.

Rezultati përbën një kthesë të rëndësishme për Shqipërinë në një prej matjeve më të ndjekura ndërkombëtare të cilësisë së arsimit. Megjithatë, vetë Kumbaro paralajmëroi se shifrat nuk duhet të lexohen si arsye për vetëkënaqësi, por si një pikënisje për të kuptuar se çfarë ka funksionuar dhe ku sistemi duhet të përmirësohet më tej.

"E rëndësishme është të kuptojmë se si PISA na ndihmon që të rrisim performancën e mësuesve dhe të nxënësve tanë. Se si secili nxënës të ketë më shumë aftësi, më shumë zotësi, që ato që mëson në shkollë t'i përdorë në jetë", u shpreh ajo.

Rezultatet e publikuara sot janë të dhënat e para të PISA 2025, ndërsa analizat e plota pritet të japin një panoramë më të gjerë mbi performancën e nxënësve, përqendrimin, aftësitë e tjera dhe ndikimin gjithnjë e më të madh të inteligjencës artificiale në procesin e të nxënësve.

Në prag të nisjes së vitit të ri shkollor, shifrat e PISA 2025 përbëjnë një sinjal të rëndësishëm për arsimin shqiptar: pas rezultateve të dobëta të ciklit të mëparshëm, nxënësit shqiptarë rikthehen me një rritje të fortë në të tre fushat bazë dhe, për herë të parë në këtë cikël, me rezultate që i vendosin në krye të rajonit në matematikë dhe shkencë.

AKTUALITET / 8 September 2026, 12:37

Operacioni/ I kërkuar nga Interpol Tirana për vjedhje me armë, arrestohet shqiptari në Greqi

AKTUALITET / 8 September 2026, 12:17

Debati për pagat e magistratëve, Balla-opozitës: Ne nuk protestojmë si ju kundër gjykatave, respektojmë vendimet e Kushtetueses

AKTUALITET / 8 September 2026, 12:11

Vlorë/ Sherr në 'beach bar' në zonën e Lungomares, konfliktohen fizikisht disa persona, ndërhyjnë policia. Një në kërkim

AKTUALITET / 8 September 2026, 12:02

Aksioni/ Shkelje në menaxhimin e mbetjeve, IKMT pezullon aktivitetin e kompanisë private dhe e mbyll

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:55

Debati te Konferenca e Kryetarëve/ Bardhi përplasët me Peleshin, për protestën e gjykatave: Zbatoni vendimin e Kushtetueses, gjyqtarët janë pa paga

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:45

Zjarret në 5 qarqe të vendit, nga Dajti në Tërbun! Ministria e Mbrojtjes: 43 vatra në 24 orë, 11 janë ende active! S'ka rrezik për banorët

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:36

Tubim pasdite/ "Ju jeni Kryesia e turpit", protestuesit mbledhen para Kryesisë së Kuvendit

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:31

Sekuestrohen kamerat/ Hajdutët vjedhin dy kasaforta, 200 milionë lekë dëm ndaj dy biznesmenëve në Berat, policia asnjë gjurmë për autorët

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:22

Detaje të reja/ "Konflikti nisi për një vështtrim", dinamika e ekzekutimit të 24-vjeçarit në Shkodër

AKTUALITET / 8 September 2026, 11:16

Kuçi mohoi dhunën nga Jozi, Policia e shpall në kërkim për moskallëzim krimi, çfarë deklaroi 26-vjeçari në komisariat

Alibeaj: Berisha nuk është lider i të gjithë opozitës. Me vizitën në SHBA fitoi vetëm bastin e tij personal! Drejton një parti të gjymtuar

'Karburantet'/ Transporti publik, 116 subjekte përfitojnë rreth 120 milionë lekë kompensim nga Tatimet

AKTUALITET / 8 September 2026, 10:59

Banorët kërkojnë pagesat për tokat, protestë para Bankers Petroleum: Nëse nuk na dëgjojnë do të bllokojmë puset e naftës!

AKTUALITET / 8 September 2026, 10:49

Pagat/ Administrata e Dhomës Civile në Gjykatën e Tiranës nis bojkotin, bllokon shërbimet: Çfarë do të bëhet me ne? Sot mbledhen gjyqtarët e prokurorët

AKTUALITET / 8 September 2026, 10:30

Ambasadorja e re e BE nisi misionin në Tiranë, takim 1 orë me Ramën në Kryeministri

AKTUALITET / 8 September 2026, 10:12

Raporti/ U helmuan 139 persona në Fushë-Arrëz, ISHP konstaton ndotje në sistemin e ujit të pijshëm

AKTUALITET / 8 September 2026, 09:56

Dinamika e ngjarjes/ Vrasja në Shkodër, autori u konfliktua fillimisht me 24-vjeçarin në një lokal, i shkoi me pistoletë në banesë!

AKTUALITET / 8 September 2026, 09:50

Përplasja për pagat e magjistratëve, Olsian Çela sot mbledhje me shëfat e prokurorive në rrethe dhe me Shoqatën e Prokurorëve

AKTUALITET / 8 September 2026, 09:38

Athina zgjohet nga shpërthimet me bomba në dy lokale në qendër, urdhri u dha prej burgut nga kreu shqiptar i një organizate kriminale!

AKTUALITET / 8 September 2026, 09:32

Nga puna në turizëm te tragjedia, ja kush është 24-vjeçari Ylber Luli, që humbi jetën në Shkodër

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.